



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURES
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 132 Prot.

Tiranë, më 30.01 2018

VENDIM Nr. 3, datë 18.01.2018

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.1, datë 18.01.2018, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të projektit "*Ndërtimi i Fabrikës së ujit dhe shfrytëzimit të burimit të ujit "Shpati i Majës së Malit", fshati Flet, Bashkia Fushë Arrëz, Qarku Shkodër*-subjekti "ERALDI &PSM" sh.p.k., realizuar nga individ i licencuar në arkeologji Znj. Lida Miraj,

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të projektit "*Ndërtimi i Fabrikës së ujit dhe shfrytëzimit të burimit të ujit "Shpati i Majës së Malit", fshati Flet, Bashkia Fushë Arrëz, Qarku Shkodër*-subjekti "ERALDI &PSM" sh.p.k., realizuar nga individ i licencuar në arkeologji Znj. Lida Miraj.
2. Subjekti "ERALDI & PSM" sh.p.k. duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili duhet të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit për projektin "*Ndërtimi i Fabrikës së ujit dhe shfrytëzimit të burimit të ujit "Shpati i Majës së Malit", fshati Flet, Bashkia Fushë Arrëz, Qarku Shkodër*, si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë subjekt.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURES
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR

MIRELA KEÇMEARI-FURXHI

MINISTRE



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO